

# TRUSTORJA

## KRYETITUJT E KËTIJ NUMRI

- \* TM4: mjetet ngritën tutje (faqe 2)
- \* Ndryshon tërheqja e pensionit (faqe 3)
- \* €332 mln. investime më 2014 (faqe 3)
- \* 37 mijë përdorues të eTrusti-t (faqe 4)

## FAKTET KRYESORE

Më 31 dhjetor 2014

Çmimi i aksionit	€1.2879
Mjetet nën menaxhim	€1,087,760,598
Pensione të shpaguara në tremujor	€3.3 mln
Pensione të shpaguara në vitin 2014	€14.3 mln
Llogari të kontribuuesve	476,559

## INVESTIMET

### Çmimi i aksionit:

Tetor	+0.20%
Nëntor	+1.87%
Dhjetor	-0.29%
Gjithsej performanca neto	+1.77%

### Kthimi bruto:


Tetor	€2.83 mln
Nëntor	€20.15 mln
Dhjetor	-€2.58 mln
Gjithsej kthimi bruto	€20.40 mln

## PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË NGA THEMELIMI



Periudha	1M	3M	Viti	1V	5V	Nga themelimi
Rezultati	-0.29%	1.77%	6.29%	6.29%	31.16%	28.79%

## PLASMANI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



## PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE DHE LV-KOSOVË NË TREMUJOR

1. VANGUARD ▲ +3.07%	4. AXA WFOI ▲ +1.16%	7. LV - KOSOVË ▲ +0.47%	10. Tobam ▲ +5.25%
2. SCHRODERS ▼ -2.57%	5. BNY MELLON ▲ +0.57%	8. Nordea GSEF ▲ +7.47%	11. KBI ▲ +4.44%
3. AXA GILB ▲ +2.19%	6. ALCEDA ▲ +1.12%	9. Nordea SRF ▲ +3.26%	12. Pictet ▼ -1.39%

BOTUES: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës - Botuar: Janar 2015

Autor: Jeton Demi

Kontakt: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10, 10000 Prishtinë - 038-244-341 - info@trusti.org - www.trusti.org

## €20 MLN KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM4

FKPK-ja e mbylli tremujorin e katërt (TM4) të 2014-s me një kthim bruto nga investimet prej rreth €20 mln. Në këtë mënyrë kthimi vjetor bruto nga investimet për 2014 shkoi në rreth €67 mln. Performanca pozitive e investimeve në TM4 ndikoi në rritjen e çmimit të aksionit për 1.77%. Çmimi i aksionit, i cili u përmbyll për vitin në €1.2879, duke u ngritur për 6.29% për këtë periudhë.

Mjetet nën menaxhim në fund të tremujorit tejkaluan shifrën €1,088 mln (TM3: €1,038 mln) duke u ngritur për €50 mln. Rritja e mjeteve nën menaxhim u ndikua më shumë nga kontributet e reja (€30 mln) dhe nga kthimi nga investimet (€20 mln). Në anën tjetër FKPK-ja shpagoi pensione prej €3.3 mln, ndali tarifën menaxhuese prej €1.4 mln dhe refondoio €0.7 mln, që reduktuan kështu mjetet nën menaxhim me rreth €5.4 mln.

### Faktorët me ndikim

Tregjet financiare globale gjatë TM4 njohën një cikël të ngjashëm rënie-ngritjesh me tremujorin paraprak. Lëkundjet e para të forta erdhën në fillim të periudhës për shkak të rënies së shpejtë të çmimit të naftës, mbylljes së programit stimulues në SHBA dhe treguesve jo të mirë të industrisë gjermane, që u pasua me një ngritje të optimizmit pas publikimit të indikatorëve pozitivë të ripërtëritjes së ekonomisë amerikane, shpresës se ulja e çmimit të naftës do të shtojë mundësitë e përtëritjes së ekonomisë globale dhe mundësisë që Banka Qendrore Evropiane (BQE) të fillojë më shpejt programin e blerjes së bonove sovraane. Megjithatë fundi i TM4 njohu edhe një rënie tjetër të tregjeve për shkak të deklarimit të BQE-së, se blerja e bonove nuk do të

# 6.29%

kthimi nga investimet në 2014

ndodhte më 2014. Si pasojë, luhatjet në tregjet financiare u reflektuan kështu edhe në luhatjen e çmimit të aksionit përgjatë TM4.

### Performanca e fondeve investuese

Dy fonde investuese kishin performancë negative këtë tremujor. Schroders (-2.57%), që tregton me instrumente fikse, u ndikua nga rënia e normave të interesit të bonove shtetërore, dhe Pictet (-1.39%), një fond investues në aksione, u prek negativisht nga rënia e çmimit të naftës, pasi rreth 12% të portofolit e ka në sektorin e energjisë. Të gjitha fondet e tjera njohën ngritje pozitive, dhe rritjen më të fortë e kishte fondi i Nordea 1-GSEF (+7.47%), i përqendruar në aksione kryesisht të pozicionuara në SHBA (61% e portofolit) dhe në sektor me rritje si TI dhe kujdesi shëndetësor; i ndjekur nga Tobam (+5.25%), fond ky me shpërndarje globale në tregun e aksioneve, por me një ekspozim të ulët në sektorin e energjisë; dhe nga KBI (+4.44%), një fond i aksioneve i përqendruar në masë të madhe në sektorët me rritje. Të gjitha fondet e tjera investuese kishin performancë të kënaqshme, të nxitura kryesisht nga përmirësimi i indekseve të aksioneve në nivel global, ose sektorëve të caktuar ekonomik (TI, financa, shëndetësi dhe produkte të konsumit të gjerë). Si zakonisht, investimet në fletobligacionet e Kosovës janë me normë të interesit që përcaktohet në ankandin primar.

**Tabela 1:** Plasmanet dhe performanca e investimeve në TM4 2014

Menaxhuesi/ Entiteti/Emetuesi	Emri i fondit/instrumentit	Plasmanet	Kthimi bruto
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€343,025,434	€10,437,450
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€166,159,683	€941,023
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€114,516,911	-€2,805,994
Nordea	1-Stable Return Fund	€100,812,922	€2,948,514
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€71,926,649	€1,458,456
KBI	Divident Plus	€54,922,848	€2,344,831
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€54,701,478	€264,057
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€50,304,385	€2,862,525
TOBAM	Anti-benchmark WEFE hedged share class	€36,661,888	€1,882,660
Pictet	High dividend selection Z EUR	€30,197,501	-€424,207
Alceda	Aquila Risk Parity 7 Fund	€28,803,675	€318,761
AXA	WF Optimal Income I EUR	€26,287,722	€337,739
ECM <sup>1</sup>	Diversified European Credit	-	-€168,276
<b>Gjithsej<sup>2</sup></b>		<b>€1,078,321,096</b>	<b>€20,397,539</b>

<sup>1</sup> Investimi në këtë fond investues është tërhequr më 9 nëntor 2014, dhe fitimi i realizuar nga ky investim ishte 460,026 euro; performanca negative në tabelën e sipërme është prej 01.10 deri më 09.11.2014. <sup>2</sup> Këtu nuk përfshihet shuma prej 9,938,218 euro në fund të TM4 që ishte e depozituar në llogarinë e FKPK-së në BQK. Për informacione të detajuara financiare për TM4 (dhe çdo tremujor paraprak) ju lutemi shfletojini raportet tremujore duke kopjuar adresën vijuese: [www.trusti.org/index.php/sa/raportet-tremujore](http://www.trusti.org/index.php/sa/raportet-tremujore)

## NDRYSHON RREGULLA PËR TËRHEQJEN E PENSIONIT

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) e ka ndryshuar në mes të muajit nëntor 2014 Rregulloren për tërheqjen e kursimeve pensionale. Sipas Rregullores së re, kontribuuesit që arrijnë moshën e pensionimit prej 65 vjeç mund të zgjedhin të tërheqin 20% të bilancit të kursimeve pensionale menjëherë. Pjesën e mbetur do ta tërheqin çdo muaj përmes programit të tërheqjes në faza derisa e gjithë shumata të shterojë. Përfundim nga ky rregull bëjnë kontribuuesit të cilët në momentin e pensionimit kanë bilanc të kursimeve pensionale nën €2,250 dhe të cilët të gjithë bilancin e llogarisë do ta tërheqin menjëherë. Pagesa minimale në programin e tërheqjes në faza është €150 në muaj.

Rregullorja në fjalë ka ndryshuar edhe mënyrën e tërheqjes së kursimeve pensionale për kontribuuesit që janë përfitues

të pensionit të invaliditetit sipas vendimit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Tërheqja e kursimeve pensionale për këtë kategori do të bëhet përmes programit të tërheqjes në faza me nga €150 në muaj deri në skadim të vendimit të MPMS-së. ose deri në shterimin e kursimeve, cilado që vjen e para. Ky ndryshim në Rregulloren nuk prek tërheqjet e kursimeve pensionale të kontributdhënësve të vdekur, trashëgimtarët e të cilëve do të mund ta tërheqin gjithë shumën e akumuluar ose ta transferojnë këtë shumë në llogarinë e tyre të kursimeve pensionale në FKPK. Për pjesën e kursimeve pensionale që tërhiqen nga përfituesit me pagesë të menjëhershme, FKPK-ja është e detyruar ta mbajë në burim tatimin e përshkallëzuar vjetor mbi shumën e pagesës së menjëhershme në përputhje me Vendimin Shpjegues Nr. 06/2014 të ATK, datë 23.12.2014.

## REKORD I LËVIZJES SË MJETEVE MË 2014

Ndryshimi i politikës investuese të FKPK-së, dhe kalimi nga stadi i alokimit të mjeteve në stadin e diversifikimit të riskut dhe alokimit të mjeteve, ka rezultuar në investimin e një vlere rekorde të mjeteve në një vit të vetëm. Ishin €332 mln. që u investuan më 2014, nga të cilat €283 mln. shkuan tek gjashtë fondet e reja investuese të angazhuara si rrjedhim i ndryshimit të politikës, por kishte edhe shtim të mjeteve (prej €49 mln.) tek disa nga fondet investuese të mëhershme. Nga shumata e investuar tek fondet e reja investuese, €142 mln janë drejtuar tek dy fondet e Nordea-s: €96 mln. në atë të multi-aseteve, Nordea 1-SRF, dhe €46 mln. në atë të aksioneve, Nordea 1-GSEF; €51 mln. tek fondi me ofrim dividende i KBI; €35 mln. tek fondi i aksioneve me diversifikim optimal i Tobam; €30 mln. tek fondi i aksioneve me ofrim dividende i Pictet, dhe €26 mln. tek fondi tjetër i AXA (WFOI), ai i multi-aseteve të korporatave dhe shteteve evropiane.

# €332 mln

investime të realizuara gjatë 2014

Ndërsa mjetet e investuara tek fondet ekzistuese ishin: €25 mln. tek fondi i multi-aseteve të BNY Mellon, €15 mln. tek fondi i bonove i Schroders dhe €9 mln. tek fondi me target bonot e lidhura me inflacionin i AXA GILB. Investimet në fletobligacionet e Kosovës kanë ndryshuar gjatë vitit sipas periudhave të maturimit dhe investimeve të reja, por ato sillleshin mes €50 e €60 mln. Investimi i vetëm që u tërhoq më 2014 ishte ai tek fondi i ECM-DEC (prej €23.8 mln) për shkak se Bordi Drejtues i ka vlerësuar si të zbehta mundësitë që ky fond investues (në fushën e kredidhënies) të ketë zhvillim të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm në të ardhmen.

## SKADON MANDATI I Z. FREDERICK ARTESANI NË BORDIN DREJTUES

Anëtari profesional i Bordit Drejtues të FKPK-së, z. Frederick Artesani, e ka përfunduar në janar 2015 angazhimin e tij në Bord, pasi organet relevante nuk e kishin iniciuar procedurën e zëvendësimit ose riemërimit të z. Artesani në Bord. Z. Artesani ka qenë anëtar i Bordit të qysh prej tetorit 2008, fillimisht i emëruar nga Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, duke e kthyer mandatin e tij në profesional pas mbarimit të misionit të Zyrës përkatëse më 2012. Z. Artesani, që për një kohë të gjatë ka qenë Kryesues i Komisionit

të Auditimit, e mbaroi mandatin e tij duke qenë Kryesues i Komisionit të Investimeve për tri vjet. Ai dha një kontribut prej eksperti në të gjitha funksionet e Bordit, veçanërisht duke revolucionizuar politikën dhe strategjinë investuese të FKPK-së, dhe bashkë me të edhe portofolion investuese të mjeteve të FKPK-së. Si një anëtar i Bordit që shumë vështirë mund të zëvendësohet, FKPK-ja e falënderon z. Artesani për gjithë kontributin e dhënë!

## PENSIONET E SHPAGUARA MË 2014 MBI €14 MLN

Vlera e pensioneve të shpaguara në 2014 ishte 14.3 mln (2013: 10.7 mln) e cila shkoi në emër të 4,049 përfituesve (2013: 3,567). Krahasuar me vitin paraprak, vlera e shpagimit u rrit për 32% ndërsa numri i përfituesve u rrit për 14%. Shpërputhja e rritjes së këtyre dy shifrave qëndron në jetëgjatësinë e përfituesve në skemë, vlerës së kontribuimit dhe ndikimit të kthimit pozitiv nga investimet. 81% e kësaj vlere iu shpague 3,096 përfituesve të pensionit të moshës (2013: 79% për 2,676 përfitues), 17% të saj e tërhoqën trashëgimtarët e 810 kontribuuesve që ndërruan jetë (2013:

# 32%

më shumë pensione të shpaguara se më 2013

19% për 740 trashëgimtarë), dhe 2% shkoi tek 143 përfituesit e pensionit të invaliditetit (2013: 3% për 151 përfitues). Nuk kishte ndonjë ndryshim domethënës në pjesëmarrjen e arsyes për tërheqje kursimesh gjatë dy vjetëve të fundit (pensionit të moshës, invaliditetit ose vdekjes).

## MBI 15 MIJË SHËRBIME TË OFRUARA NË TM4

Numri i shërbimeve të ofruara nga FKPK gjatë TM4 pësoi një ngritje prej 39% krahasuar me periudhën paraprake (TM3: 11,121 shërbime), dhe arriti kështu në 15,421 shërbime të ofruara. Rritja në këtë masë ishte edhe pritshme duke qenë se në TM3 numri i shërbimeve kishte rënë me 13%, për shkak të periudhës së pushimeve. Rritja e numrit të shërbimeve është reflektuar më shumë nga rritja e numrit të pasqyrave të shtypura (+24%) dhe shtimit të kërkesave për hapje të llogarisë elektronike eTrusti (+51%). Njëkohësisht në këtë periudhë kishte rënie të numrit të kërkesave të miratuara për pensionim (-32%). Për të njëjtën periudhë numri i shërbimeve të vetëkryera nga kontribuuesit përbënin

rreth 12.4% të totalit të shërbimeve (TM3: 10.0%), ose 1,909 sosh (TM3: 1,514).

Përveç shërbimeve të ofruara, gjatë TM4 janë kthyer edhe 13,488 pasqyra vjetore të pashpërndara nga Posta e Kosovës për adresë të pasaktë të kontribuuesve përkatës (TM3: 4,356 pasqyra të tilla), të cilat janë regjistruar nga stafi i FKPK-së me qëllim kontaktimin e kontribuuesve për korrigjimin ose gjetjen e adresave të tyre të sakta. Në total për vitin 2014 numri i shërbimeve të ofruara nga FKPK-ja arriti në 59,180 (2013: 49,486), ose një rritje prej 20%.

## TEJKALOHET OBJEKTIVI VJETOR PËR KONTRIBUTET E PABARAZUARA

Kontributet pensionale për të cilat FKPK-ja nuk ka informacion se kujt i takojnë (nga mosdërgimi i të dhënave nga punëdhënësit) në fund të vitit 2014 arritën pikën më të ulët historikisht. Falë angazhimit shtesë të stafit të FKPK-së mjetet e pabarazuara ranë në 1.11% të totalit të kontributeve të arkëtuara gjatë 2002-2012, ose 10.8 mln (TM3: 1.20% dhe 11.35 mln respektivisht) duke tejkaluar objektivin e vënë

nga Bordi Drejtues prej 1.12% për fundvitin e përfunduar më 31.12.2014. Gjendje mjaft e kënaqshme paraqitet edhe tek barazimi i kontributeve të arkëtuara për vitin 2014, ku niveli i mjeteve të pabarazuara ka rënë në 0.27% (TM3: 0.31%), ose në vlerë €348 mijë nga rreth €129 mln. Pjesa më e madhe e kësaj shume besohet se janë gjoba/interesa që duhen refunduar tek ATK-ja kur vërtetohen të tilla.

## MBI 37,000 PËRDORUES TË eTRUSTIT NË FUND TË 2014-s

Numri i përdoruesve të shërbimit elektronik eTrusti vazhdoi me rritje edhe më TM4, duke arritur në 37,222 përdorues (TM3: 35,223). Në terma vjetor rritja e numrit të përdoruesve të eTrustit më 2014 mund të vlerësohet tejte e kënaqshme, me një rritje prej 66% krahasuar me fundvitin 2013, kur ky numër ishte 22,459. Rritja erdhi falë fushatave televizive të ndërmarra gjatë TM1 e TM2,

të 2014-s. Megjithatë numri i përdoruesve të eTrusti-t ende vazhdon të jetë i vogël krahasuar me numrin e kontribuuesve (2014: 452 mijë) duke përbërë kështu vetëm 8% të këtij numri. Përprjekjet e stafit të FKPK-së për promovimin e këtij shërbimi do të vazhdojnë edhe gjatë 2015-s, si përmes fletushkave të shpërndara në zyrën e FKPK-së dhe formave të tjera të komunikimit.